



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 73/2012
Prishtinë, më 04.09.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Berat Buzhala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të tjerë: Jan Perkins, Philipp Annawitt dhe Shpend Qamili - OSBE; Dita Dobranja – INDEP; Flamur Hyseni-NDI dhe Florije Mehmeti--KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.08.2012;
3. Diskutim në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve në kuadër të fushëveprimit të Komisionit;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.08.2012

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28 .08.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve në kuadër të fushëveprimit të Komisionit

Kryetari theksoi se në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve në kuadër të fushëveprimit të Komisionit, sot kemi këtu edhe përfaqësuesit e OSBE-së të pranishëm në mbledhje. OSBE-ja ka shprehur gatishmëri të na përkrahë në këtë drejtim, për ta parë së sa po zbatohen ligjet e miratuar nga Kuvendi. Pastaj fjalën ia dha përfaqësuesve të OSBE-së për ta paraqitur idenë për ta përkrahur Komisionin në fushën e mbikëqyrjes së Ministrive dhe Agjencive ose Rregullatorëve.

Philipp Annawitt (përfaqësues nga OSBE-ja) - Prezantoi idenë së si e kanë paraparë të ju ofrojnë Komisionit mbështetjen në monitorimin e mbikëqyrjes së shpenzimeve financiare lidhur më tri Ministrinë e linjës dhe për Agjencitë përkatëse edhe brenda Ministrive, në kuadër të fushëveprimit të Komisionit. Tha në këtë aspekt mund të ju ofrojmë për mbështetje një ekspert në fushën e mbikëqyrjes së shpenzimeve publike, ku mund të asistojmë në përpilimin e planit të veprimit, pyetësorit, dëgjime publike dhe në hartimin e raportit final.

Ian Perkins - (Ekspert nga OSBE-ja) kërkoi nga Komisioni që ta zgjedhin një nga Ministrinë ose Agjencitë së cilën prej tyre vendosin ta monitorojnë, së si i shpenzojnë mjetet financiare dhe buxhetin në tërësi. Tha që rezultati i mbikëqyrjes financiare mund të jetë në fund me sugjerimet dhe rekomandimet e Komisionit se në cilat fusha duhet të rritet efikasiteti për mënyrën e shpenzimeve.

Kryetari – Falënderoi gatishmërinë për përkrahje nga OSBE-ja, dhe theksoi se në fushëveprimin e Komisionit është mbikëqyrje e zbatimit të ligjeve, por brenda funksionimit të ligjeve kemi dhe anën shpenzimeve buxhetore, prandaj në këtë drejtim duhet ta zgjedhim modelin më të avancuar të mënyrës së mbikëqyrjes të Ministrive ose edhe të funksionimit të Agjencive. Propozoj të nxjerrët një listë e të gjitha Ligjeve të miratuara në kuadër të fushëveprimit të Komisionit, dhe pastaj Komisioni do të vendosë së cilat ligje do t'i përzgjedhim për monitorim.

Ramiz Kelmendi – Tha se ne duhet ta ndryshojmë edhe Planin e punës së Komisionit dhe të shohim se cilat ligje ka nevojë të monitorohen dhe pas një analize të saktë mund të vijmë edhe të ndryshimi dhe plotësimi i tyre, i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit.

Myzejane Selmani - Tha se Plani i Punës së Komisionit për vitin 2012 është i miratuar, por esenca është se si të arrihet që të zbatohen ligjet, ose të shihen pengesat që mund të hasin Ministrinë dhe Agjencitë gjatë zbatimit të ligjeve.

Sala Berisha – Shala – Tha që paraqitja e përfaqësuesve të OSB-së më tepër ka të bëjë me Komisionin për mbikëqyrje të financave publike. Por ne, si Komision, mund t'i marrim përvojat e tyre për mbikëqyrje në ta. Pastaj kur ta kemi një listë të ligjeve të miratuara të përcaktohemi së cilin ligj do ta monitorojmë.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Të hartohet një listë më të gjitha Ligjet e miratuara deri më tani që janë në fushëveprimin e Komisionit dhe, pastaj Komisioni të merr vendim së cilin Ligj do ta mbikëqyrë.

4. Të ndryshme

Çështje vijuese;

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit